



9/7 KBL
18.5.26

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASENIT LUMOR ERZEN

VENDIM

Nr.6, datë 04/05/2026

PËR

MIRATIMIN E LEJES PËR NXJERRJE DHE SHFRYTËZIM TË UJIT
NËNTOKËSOR NËPËRMJET SHPIMIT, PËR QËLLIME TË
NDRYSHME, TË SUBJEKTIT “DIJON ALBANIA” SH.A, ME
VENDNDODHJE: LAGJJA FARKA E MADHE, NJËSIA
ADMINISTRATIVE FARKË, TIRANË.

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 141, të ligjit nr.29/2024, “Për Burimet Ujore”, i ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.319, datë 11.06.2025, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për përdorim burimi ujor, dokumenteve shoqëruese, procedurës së shqyrtimit e vendimmarrjes, formateve të lejes, autorizimit, kushteve të posaçme dhe afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Basenit Lumor Erzen,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për leje për nxjerrje dhe shfrytëzim të ujit nëntokësor nëpërmjet shpimit, për qëllime të ndryshme (përdorim të brëndshëm sanitar), të subjektit “Dijon Albania” sh.a, me vendndodhje: Lagjja Farka e Madhe, Njësia Administrative Farkë, Tiranë.
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e burimit ujor (pus-shpimi):

- X= 489368.5
- Y= 4572960.41
- Z= 188.42 m

- Sasia e ujit që jepet në përdorim : $Q = 0.5 \text{ l/sek}$
- Qëllimi i përdorimit të ujit: Përdorim të brendshëm sanitar.
- Thellësia e pus-shpimit: 170 m
- Thellësia e vendosjes së pompës : 160 m
- Koordinatat e pikës së shkarkimit:

$X = 489348.2;$

$Y = 4572920.1;$

$Z = 186.9 \text{ m}$

- Prurja që shkarkohet: $Q = 0.4 \text{ l/sek}$

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

KRYETARI I KBL ERZEN

SHKËLQIM HAJDARI

